



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari Komunës merr:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E KOORDINATORËS PËR INTEGRITET PËR KOMUNËN E
LIPJANIT**

Neni 1

Me këtë Vendim LINDA SHAHINI, në pozicionin e punës Zyrtare për Integritet Evropian, **CAKTOHET**, Koordinatorë për Integritet për Komunën e Lipjanit .

Neni 2

Koordinatorja për Integritet është përgjegjëse për:

përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;

- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- përgatitë dhe shpërndan pyetësozin si dhe zhvillon intervistat me stafin komunal, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;

- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planit të Integritetit;
- harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton kryetarit.

Koordinatorja, gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatorja i rekomandon Kryetarit për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesia e grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit dhe Koordinatorja Linda Shahini.

1Nr. 112/02-48543
Lipjan, më 08.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

